

URDHËR
Nr. 923, datë 28.10.2024

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË
KOMPETENCAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81/2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:
 - a) përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të platformës së diplomacisë ekonomike;
 - b) energjizimin e administratës publike.
 2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.
 3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara, që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.
 4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.
 5. Urdhri nr. 46, datë 31.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani